

Të nderuar kolegë deputetë,

Për fatin e keq, Shqipëria është një nga vendet e rralla në Europë që nuk zhvillon zgjedhje. Pranimi nga ana e maxhorancës e komisionit hetimor që kërkon opozita për zgjedhjet, shpresoj të jetë një sinjal i mirë, por kam frikën që do të jetë një tendencë për të mbuluar problemet zgjedhore, problemet reale me të cilat ndeshen shqiptarët gjatë procesit zgjedhor, të cilat ne që jemi në këtë sallë i dimë fort mirë. Që të ndodhë kjo, që t'i lexojmë realisht problemet dhe të arrijmë të kemi zgjedhje të lira dhe të ndershme, së pari duhet të dimë të lexojmë qartë ashtu siç shkruhen raportet ndërkombëtare. Jo opozitat i lexojnë nga e majta në të djathtë që zgjedhjet janë të manipuluar dhe maxhoranca, arabisht, nga e djathtë në të majtë që zgjedhjet kanë qenë një hap përpara. Raporti i OSBE/ODIHR-it ka përcaktuar qartë se zgjedhjet në Shqipëri blihen, votuesit intimidohen, partia në pushtet dhe shteti janë njësuar në një, burimet e shtetit përdoren për interesa politike dhe ky është një krim elektoral, dhe nga ana tjetër intimidohen votuesit duke u vjedhur atyre të gjitha të dhënat personale dhe duke përdorur të ashtuquajturit patronazhist për t'u shërbyer interesave të partisë dhe të pushtetit. Unë nuk kuptoj se çfarë duam më shumë se kaq për të arritur në një përfundim të gjithë së bashku që kjo situatë është jashtëzakonisht alarmante dhe kërkon së pari, që ne të jemi koshientë si deputetë, përfaqësues të qytetarëve, për të garantuar votën e lirë të tyre?! Doni më shumë se kaq? Ka edhe më shumë se kaq. Ndryshimet kushtetuese që ju bëtë për tri ditë nuk ndodhin në asnjë vend anëtar të NATO-s apo të Bashkimit Europian, bile në asnjë vend që ka parlament. Këtu kemi edhe ne përgjegjësinë, që ju lamë ju të bënit pazare antikushtetuese dhe këtë institucion kushtetues ta ktheni në institucion pazaresh për të ndryshuar Kushtetutën dhe për të bërë një kod zgjedhor, i cili synonte të mos lejonte koalicionet dhe të vendoste në tryezë se kush duhet të fitonte zgjedhjet, për t'i shtuar më tej manipulimin e procesit zgjedhor. Ky komision duhet të gjykojë se çfarë duhet bërë që të ketë zgjedhje në Shqipëri dhe shpresoj që ky të jetë fryti i punës së tij, jo vetëm të tregojë me gisht cilat janë problemet, por cilat janë zgjidhjet për një reforme zgjedhore, e cila nuk synon pazare, por të vërtetën e kriterëve të Kopenhagenit, të vërtetën që duan shqiptarët, që të votojnë si qytetarë të lirë.

Për sa i përket komisionit tjetër, unë nuk do të hyj në analizë kushtetuese apo ligjore, sepse e bënë kolegët e mi dhe pajtohem 100% me ta. Padyshim, pajtohem me thirrjen që ne këtu duhet të mbrojmë interesin publik, por interesi publik, të nderuar kolegë, nuk mbrohet vetëm duke u qarë për atë që ka bërë arbitrazhi me financat e këtij vendi, para që i paguajnë qytetarët shqiptarë, të cilët sot janë në kushtet e varfërisë ekstreme, por duke parë realisht pse ndodh kjo. Në gjykimin tim ndodh, sepse Kryeministri është mbi ligjin, Kushtetutën, sepse ky parlament bën ligje, të cilat nuk kanë interesin e qytetarëve të drejtën primare, por interesat selektive, politike, korruptive. Nuk është vetëm gjykata e arbitrazhit, që kemi pranuar të gjithë bashkë, ajo që duhet të gjykojë marrëdhëniet tilla me biznesmenë ndërkombëtarë. Shikoni edhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut për çështjen e pronës, që janë me qindra miliona euro. Të gjitha këto vijnë me një kosto të drejtpërdrejtë për qytetarët shqiptarë. Nuk është qeveria ajo që i paguan, por janë qytetarët. Kostoja më e madhe që ka sot shoqëria shqiptare është se ka një Kushtetutë që nuk respektohet, se ka një qeverisje që nuk respekton qytetarët, Kushtetutën dhe ligjet e këtij vendi, se ne këtu në parlament nuk ndahemi në detyrat dhe funksionet tona kushtetuese si deputetë apo përfaqësues politikë, për të kontrolluar qeverinë, në radhë të parë, dhe për të bërë ligje të drejta, në radhë të dytë, por ndahemi sipas kërkesave dhe

interesave të momentit. Prandaj, dua ta mbyll fjalën time me urimin që këto komisione të mos kthehen në teatrin e radhës të parlamentit shqiptar!